REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RAPORT
PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTLIGJIT "PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË"

1. Titulli i projektaktit

Projektligj "Për efiçencën e energjisë".

Projektligji "Për efiçencën e energjisë" është nismë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Ai synon të zëvendësojë ligjin nr. 124/2015, datë 12.11.2015, "Për efiçencën e energjisë", të ndryshuar, dhe të përafrojë kuadrin kombëtar me Direktivën (BE) 2023/1791 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 shtator 2023, për efiçencën e energjisë dhe ndryshimin e Rregullores (BE) 2023/955 (riformulim).

Ky projekt-ligj ka për qëllim të përcaktojë një kuadër masash për të promovuar efiçencën energjetike me qëllim që të sigurohet arritja e objektivave kombëtare dhe mundësohen përmirësime të mëtejshme të efiçencës energjetike në të gjithë sektorët duke sjellë përdorim racional të burimeve energjetike si dhe rritjen e konkurreshmërisë së operatorëve.

Ky projekt-ligj ka si objektiv:

a) vendosjen e efiçencës energjetike në krye për të gjithë sektorët;
b) heqjen e pengesave në tregun e energjisë për furnizimin, transmetimin, ruajtjen si dhe përdorimin e energjisë.;
c) përcaktimin e objektivave kombëtare për kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji;
d) rritjen e konkurrueshmërisë së operatorëve.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji dhe dokumentacioni shoqërues u publikuan në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike më 20 nëntor 2025. Konsultimi u mbyll më 28 korrik 2026. Periudha e publikimit ka tejkaluar afatin prej 20 ditësh pune të parashikuar për konsultimin publik.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese…, dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.
Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.
Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Mundësia për informim dhe paraqitje të mendimeve, sugjerimeve ose komenteve u sigurua nëpërmjet këtyre metodave:

1. Publikimit të projektligjit dhe dokumenteve shoqëruese në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, në rubrikat e konsultimit me qytetarët dhe ekspertët, gjatë periudhës 20.11.2025–28.7.2026;
2. Publikimit të projektligjit dhe paketës shoqëruese në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas dokumentacionit të konsultimit;
3. Mundësisë së komunikimit nëpërmjet adresës elektronike të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.
Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.
Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projek-ligji është përgatitur nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive te Zhvillimit te Industrise dhe Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Procesi i konsultimit publik ishte i hapur për qytetarët, ekspertët e fushës, shoqërinë civile dhe subjektet që preken ose kanë interes për zbatimin e politikave të efiçencës së energjisë. Në varësi të fushës së veprimtarisë, këtu përfshihen institucionet publike qendrore dhe vendore, Agjencia për Efiçencën e Energjisë, subjektet e tregut të energjisë, bizneset, konsumatorët fundorë, profesionistët dhe organizatat e interesit.

Këto kategori identifikojnë grupet që mund të ndikohen nga projektligji ose të japin kontribut në konsultim.
Gjatë procedurës së konsultimit publik nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë koment apo propozim.

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimit e pranuara sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Sipas të dhënave të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, rezultojnë 693 lexime nga qytetarët dhe 748 nga ekspertët, si dhe nuk janë regjistruar komente. Për rrjedhojë, nuk ka komente për t'u klasifikuar si të pranuara, të pranuara pjesërisht apo të refuzuara dhe nuk ka arsyetime individuale për t'u pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/ I pranuar pjesërisht/ i refuzuar)	Justifikimi